

Ne baze te parashikimit te Nenit 6 te Aktit te Themelimit te Shoqerise GEN-I Tirana Sh.p.k. dhe ne baze te Statutit te themeluesit te dates 13/12/2016, Themeluesi GEN-I, trgovanje in prodaja elektricne energjije, d.o.o., Vrbina 17, 8270 Krško, Slovenia, perfaqesuar nga Z. Robert Golob, Ph.D. - Kryetar i Bordit Drejtues dhe Z. Andrej Šajn, M.Sc. – Anetar i Bordit Drejtues bazuar ne ekstraktin e Regjistrimit Tregtar Slloveni (referuar ketu e meposhte : GEN-I, d.o.o. themelues dhe/ose Ortak i Vetem),

Miraton sa me poshte:

STATUT I Shoqerise GEN – I Tirana Sh.p.k.

Preambul:

Themeluesi, duke njohur faktin se ka interesa te legjitimuara per te themeluar nje Shoqeri ne Shqiperi dhe te hyje ne tregun Shqiptar te Energjise Elektrike,

per me teper, per shkak dhe nepermjet te punesurave te tij dhe nepermjet te punesuarve te themeluesit te saj me seli ne Lubjane (Sloveni), ka fituar nje mase te kosiderueshme njohurie, eksperience, teknologji dhe informacion lidhur me shitjen dhe tregesine e energjise elektrike,

per me teper, per shkak te synimit per te mundesuar prodhuesit te optimizojne shitjen e energjise elektrike qe ato prodhojne, dhe ti ofrojne konsumatorit nje sherbim cilesor furnizimi me energji elektrike ne menyre qe optimizojne rruget e tyre te blerjes,

Themeluesi, i permendur ne Nenin 1, themelon nje shoqeri private Shpk me ortak te vetem, ne perputhje me dispozitat e Ligjit Shqiptar Nr. 9901 date 14.4.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (ketej e tutje i quajtur “Ligji per Shoqerite”) per t’u angazhuar ne aktivitetet biznesi si me poshte:

1. Themeluesi i kompanise

1.1. Emri i gjate i Shoqerise Themeluese: GEN-I, trgovanje in prodaja elektricne energjije, d.o.o.

Emri i shkurtuar i Shoqise Themeluese: GEN-I, d.o.o.

Numri i rregjistrimit i Themeluesit: Gjykata e Rrethit Krško – Departamenti te Drejtes Tregtare 158774000

1.2. Selia e regjistruar e Themeluesit: Vrbina 17, 8270 Krško, Slovenia.

1.3. Personat e veshur me tagren e perfaqesimit te Themeluesit/ Ortakut te Vetem jane Menaxheret e GEN-I, trgovanje in prodaja elektricne energjije, d.o.o. sipas listimit ne Ekstraktin e Regjistrit Tregtar Slloveni.

1.4. Themeluesi ketu e me poshte pergjate ketij dokumenti do te quhet "Ortak i Vetem"

1.5. I autorizuar per sherbimin e procesit:

Naim Isufi, Avokat, mbajtes i licenses nr. 651, date 29/12/1997
Rr. Ismail Qemali Nr. 27, Kulla Fratari, Kati 1, Tirane

2. Emri i Shoqerise, forma ligjore dhe selia e saj e rregjistruar

2.1. Emri i gjate i Shoqerise: "GEN-I, Tirana Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar"

2.2. Emri i shkurtuar Shoqerise: "GEN-I, Tirana, Sh.p.k."

2.3. Emri i gjate Shoqerise ne Anglisht: "GEN-I, Tirana Limited Liability Company"

2.4. Emri i shkurter i Shoqerise ne Anglisht: " GEN-I, Tirana Ltd".

2.5. Selia e rregjistruar e Shoqerise : Ish – Noli Business Center, Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tirana.

2.6. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise nen drejtimin e Administratorit.

2.7. Shoqeria, per shkak te aktivitetit te saj te biznesit, mund te hape dege, agjensi dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe vendin me vendim te Administratorit.

2.8. Shoqeria mund te hape dege, agjensi dhe zyra perfaqesimi jashte territorit te Shqiperise me aprovimin paraprak te Ortakut te Vetem.

3. Fusha e aktivitetit te Shoqerise (Objekti).

3.1. Aktiviteti paresor/kryesor i biznesit: Tregjetia Energjise Elektrike sipas Legjislacionit Shqiptar ne fuqi per Sektorin e Energjise Elektrike si dhe cdo aktivitet tjetër per shkak dhe te lidhur me objektin e mesiperm.

4. Kohezgjatja e Shoqerise

4.1. Shoqeria themelohet per nje kohe te pakufizuar. Ajo fillon aktivitetin me rregjistrimin e shoqerise ne Rregjistrin e Shoqerive prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe pas marrjes se licences se nevojshme sipas percaktimeve te Ligjit Nr. 43/2015 „Per Sektorin e Energjise Elektrike“ si dhe cdo akt tjetër ligjor apo nen ligjor ne fuqi.

4.2. Viti i biznesit te shoqerise eshte i njejt me vitin kalendarik. Viti i pare i biznesit fillon kur shoqeria fillon aktivitetet e saj dhe mbaron me 31 dhjetor te po atij viti.

5. Kapitali Themeltar i Shoqerise, numri dhe vlere e kuotave

5.1. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 6,050,000.00 (gjashte milion e pesedhete mije leke shqiptare) dhe perbehet vetem nga kontributi ne para. Kapitali ndahet ne 1 (nje)

pjese e barabarte me nje vlere nominale 6,050,000.00 Leke (gjashte milion e pesedhete mije leke shqiptare), teresisht i nenshkruar dhe paguar nga Ortaku i Vetem.

Ortaku i Vetem Shoqerisa GEN-I, d.o.o. zoteron 100% (njeqind perqind) te kapitalit themeltar te Shoqerise GEN-I, Tirana Sh.p.k.

Pergjegjesia e Ortakut te Vetem per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e shoqerise.

5.2. Ortaku i Vetem e detyron veten te paguaje sasin e e plote te kontributit ne para ne nje llogari bankare depozite tek banka ku ai mban llogarite ose prane nje noteri 8 dite pasi eshte deklaruar (nenshkruar) ky Statut, por perpara aplikimit prane Qendres Kombetare te Biznesit per te regjistruar shoqerine ne Regjistrin Tregtar. Pagesa e fondeve themeltare vertetohet me mandat pagesen nga banka/noteri sipas percaktimeve te ligjit Nr.9901 date 14.4.2008 "Mbi Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

5.3. Ortaku i Vetem nuk eshte i detyruar t'i siguroje sherbime ndihmuese shoqerise.

5.4. Pas rregjistrimit te shoqerise, te drejtat e Ortakut te Vetem (Themeluesit) dhe pjesa e tij ne asetet e shoqerise perfaqesohet nga kuotat e biznesit ne shoqeri.

5.5. Ortaku i Vetem/Themeluesi mund te lejoje ortak te tjere pjesmarres te rinj ne shoqeri ne cdo kohe. Nese, per shkak te ndarjes se kuotave ose rritjes se kapitalit fillestar, anetare te rinj pranohen ne shoqerine me Ortak Vetem dhe ne kete menyre ajo kthehet ne shoqeri me shume se nje ortak, atehere orkatet duhet duhet te bejne ndryshimet perkatese ne statut dhe te lidhin nje Kontrate Partneriteti (kontrate e ortakeve) dhe duhet te kerkojne rregjistrimin e ndryshimeve prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe beje publikimet perkatese ne perputhje me dispozitat ligjore qe lidhen me proceduren e ndryshimit te statutit te Statutit.

6. Forma e kuotave te kapitalit dhe transferimi i tyre

6.1 Pjeset e kapitalit te shoqerise nuk mund ti nenshtrohen shitjes ne burse. Transferimet e kuotave te kapitalit themeltar do te vertetohen nga Noteri.

7. Rritja e kapitalit

7.1 Vendimi lidhur me rritjen e kapitalit merret nga Ortaku i Vetem.

7.2 Kapitali mund te rritet nepermjet kontributeve ne para sipas procedurave te percaktuara ne Nenin 168 te ligjit Nr. 9901 te dates 14.4.2008 mbi Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

7.3 Rritja e kapitalit mund te behet edhe me kontribute ne natyre. Ne kete rast kontributi duhet kryer sipas Nenit 168 te ligjit Nr. 9901 te dates 14.4.2008 mbi Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

8. Zvogelimi i kapitalit

Vendimi per te zvogeluar kapitalin merret nga Ortaku i Vetem. Projekti per uljen e kapitalit themeltar duhet t'i komunikohet eksperteve te autorizuar kontabel, nese ka ndonje, 30 dite nga data e mbledhjes se Asemblese se Pergjithshme lidhur me kete çeshtje. Ekspertet duhet t'i bejne te ditur Ortakut te Vetem vleresimin e tyre dhe arsyet e zvogelimit te kapitalit.

9. Funkionimi i Shoqerise, vendimet e Ortakut te Vetem

9.1. Vendimet qe jane kompetence e Asamblese duhet te meren nga Oraku i Vetem, i cili duhet t'i informoje drejtuesit ekzekutive per kete me shkrim.

9.2. Ortaku i Vetem ka kompetence eskuzive per te marre vendime lidhur me:

- miratimin e raportit vjetor te pergatitur ne perputhje me percaktimet e Ligjit per Kontabilitetin, si dhe shperndarjen e fitimit perkatesisht,
- caktimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- pagen (kushtet e pages baze) te drejtuesve ekzekutive,
- miratimin e rregullave procedurale per drejtuesit ekzekutive,
- ndryshimet ne Statut, dhe mbylljen e shoqerise,
- rritjen dhe zvogelimin e kapitalit themeltar,
- caktimin e auditoreve te raporti vjetor,
- miratimin e politikave baze te biznesit;
- themelimin e filialeve,
- kompetencat e themelimeve sipas dispozitave te nenit 2.8 te ketij Statuti,
- çeshtje te tjera te percaktuara ne Ligj ose nga ky Statut.

9.3. Ortaku i Vetem mund te perfaqesohet nga perfaqesuesi i tij ligjor ose nga ndonje tjetër person i autorizuar prej tij per kete perfaqesim; autorizimi ose prokura duhet te redaktohet ne nje instrument autentik ose me ane te nje dokumenti privat qe perfaqeson nje prove konkluzive.

9.4. Me perjashtimet e percaktuara nga legjislacioni ne fuqi, Ortaku i Vetem nuk eshte pergjegjes per detyrimet e shoqerise.

10. Shperndarja e fitimit, mbulimi i humbjeve,

10.1. Ortaku i Vetem ka te drejte te marre nje pjese nga fitimi i taksuar i shoqerise, ne perputheje me perputhje me Legjislacionin ne fuqi, i cili eshte siguruar per vitin aktual/korent ushtrimor dhe eshte urdheruar per shperndarje, ose nga shtesa e fitimit te taksuar nga rezervat e fitimit qe jane siguruar nga ky vit ne perqindje ne raport te drejte me pjeset e kapitalit. Fitimi i paguhet Ortakut te Vetem. Fitimi mund te paguhet ne para

K

ose ne natyre. Ortaku i Vetem ka te drejte te marre fitim vetem ne perpjestim te drejte me kontributin e tij/tyre ne kapitalin themeltar te paguar.

10.2. Ortaku i Vetem mund te marre nje vendim per pagesen e fitimit te perkohshem gjate periudhes se miratimit te dy raporteve vjetore te njepasnjeshem, te pergatitur sipas Legjislacionit perkates ne fuqi, nese:

a) sipas bilancit te perkohshem, te pergatitur per kete qellim sipas Ligjit te Kontabilitetit, Shoqeria ka fonde te mjaftueshme per te mbuluar keto fitimi te perkohshme, me kusht qe pagesa te tilla te mos tejkalojne sasine e fitimeve te siguruara pas mbylljes se librave te vitit financiar te cilit i perket raporti i fundit vjetor, llogaritur sipas Ligjit te Kontabilitetit ose ndonje akti tjeter ligjor ne fuqi, ose sasine nga shtesa e fitimit te taksuar nga rezervat e fitimit qe jane siguar nga ky vit, si dhe qe pagesa per keto fitime te perkohshme te mos behet nga kapitali themeltar i kompanise-i rregulluar sipas legjislacionit ne fuqi, per te ulur pjesen e tij ne kapital; dhe

10.3. Fitimi llogaritet ne menyre periodike ne perputhje me ligjet e zbatueshme per kontabilitetin e shoqerive dhe te veprimeve financiare. Fitimi ndahet sipas nje propozimi te administratorit/administratoreve te shoqerise .

10.4. Pasi shperndahet fitimi per qellime te detyrueshme te percaktuara ne ligj, dhe nese kushtet ekzistuese ose pritesa te tregut e kerkojne kete, te tjera rezerva fitimi mund te krijohen duke perdorur me shume se gjysmen e fitimit neto te ngelur.

10.5. Perdorimi i fitimit te shperndashem duhet te percaktohet nga Ortaku i Vetem, ne baze te nje propozimi te administratorit/administratoreve te shoqerise.

10.6. Kur percaktohet perdorimi i fitimit te shperndashem, Ortaku i Vetem nuk detyrohet dhe kushtezohet nga propozimi i administratorit/administratoreve, por nga raporti vjetor i miratuar.

10.7. Pervet qellimeve te percaktuara nga legjislacioni, fitimi i shperndashem mund te kaloje per perfitim te administratorit/administratoreve.

10.8. Data e pagimit te fitimit dhe kushtet e tjera te nevojshme te pageses duhet te percaktohen nga Ortaku i Vetem.

10.9. Humbja duhet te mbulohet nga burimet e meposhtme:

- fitimet neto te vitit te biznesit ose fitimet neto te periudhave te meparshme,
- rezervat e tjera te fitimit,
- rezervat kapitale dhe te detyrueshme dhe, ne rast se kjo nuk eshte e mjaftueshme
- pakesimi i kapitalit.

10.10. Humbja mundet po ashtu te mbulohet nga pagesat e bera nga Themeluesi/Ortaku i Vetem.

11. Drejtimi shoqerise

11.1 Administratori i shoqerise caktohet Z. Igor KOPRIVNIKAR, lindur me 06.09.1973 ne Maribor, me Nr.Pass: PB 0606399

Perfaqesues per sherbimet dhe veprimet ne emer dhe per llogari te Administratorit eshte: Naim Isufi, Avokat, mbajtes i lejes Nr. 651 date 29.12.1997 me adrese: Rr. Ismail Qemali No.27, Kulla Fratari, Kati Ire, Tirane.

Administratori emerohet per nje periudhe te percaktuar prej 5(pese) vitesh.

11.2. Administratori pranon emerimin ne kete post, dhe ne nje dokument te veçante qe i bashkangjitet ketij Statuti, ai deklaron se nuk ka ndonje rrethane te permendur ne Ligjin Nr. 9901 te dates 14.4.2008 mbi Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare qe aplikohet mbi te dhe qe do t'i ndaloje atij te emerohet si administrator i shoqerise.

11.3. Paga e administratorit, nese vendoset qe mbajtesit e ketij pozicioni te marrin page, do te vendoset nga Ortaku i Vetem. Ortaku i Vetem do te nenshkruaje kontratat ndermjet shoqerise dhe administratorit/administratoreve ne emer te shoqerise.

Emerimi i administratorit eshte me te drejte riprteritje. Ortaku i Vetem mund te pushoje administratorin/administratoret ne çdo kohe, pa patur nevojën per te dhene arsye ligjore per revokimin e bere.

Administratori i permendur ne piken 11.1. te ketij Statuti ka autoritetin qe te ushtroje te drejten e Punedhenesit ne lidhje me punonjesit e shoqerise.

11.4. Administratori duhet te plotesoje detyrat e tij ne menyre te pavarur dhe ti nenshtrohet vetem nga rregullimet ligjore dhe Statuti; Ortaku i Vetem mund ta udhezaje administratorin me shkrim; ne kete rast administratori eshte i detyruar ta permbushe udhezimin/et e Ortakut te Vetem. Vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet te bejne pjese te librit te vendimeve.

11.5. Pasi shoqeria te regjistrohet, Ortaku i Vetem mund te vendose nese drejtimi i shoqerise do te perbehet nga dy ose me shume administratore Te drejtat dhe detyrimet e secilit nga administratoreve duhet te jene te njejta. Ne rast se adminstrimi perbehet nga me shume se nje adminstrator, administratoret duhet te marrin vendimet me unanimitet pervec rastit kur parashikohet ndryshe me ndonje rregullore te drejtimit te miratuar me vone lidhur me ndarjen eventuale te pergjegjesive te drejtoreve. Ortaku i Vetem duhet te miratoje rregulla detyruese te procedures qe rregullojne aktivitetet e administratorit, marredheniet ligjore mes administratoreve, procesin e vendim-marrjes. Rregullat dhe procedurat e drejtimit perfshijne nje pershkrim te detajuar te veprimeve dhe operacioneve ligjore qe administratoret e shoqerise mund te kryejne, vetem nese ato jane miratuar paraprakisht nga Ortaku i Vetem, si dhe rregulla te tjera te rendesishme lidhur

me veprimet e administratoreve dhe me procesin e vendim-marrjes. Ortaku i Vetem mund te ndryshoje rregullat e drejtimit ne çdo kohe. Administratoret duhet t'i perfshijne vendimet e tyre ne librin e vendimeve. Ortaku i Vetem mund t'i quaje te pavlera vendimet e tyre, nese ato nuk jane te regjistruara ne librin e vendimeve.

11.6. Administratori eshte pergjegjes per veprimet e tij tek shoqeria ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 te dates 14.4.2008 Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe/ose me percaktime te tjera te Kodit Civil. Administratori duhet te pergatise raportet vjetore te shoqerise.

11.7. Administratori duhet te kerkoje miratimin e Ortakut te Vetem perpara se sa te realizoje transaksione qe dalin nga ecuria normale e biznesit te shoqerise. Ndermjet te tjerash, transaksionet e meposhtme konsiderohen qe jane jashte ecurise normale te biznesit te shoqerise:

- blerja, shitja apo hipotekimi i ndertesave e apartamenteve, nese vlere individuale ose totale e tyre e kalon dhjete perqind te kapitalit te shoqerise.
- blerja, shitja apo hipotekimi i pasurive te tjera te paluajtshme, nese vlere individuale ose totale e tyre e kalon dhjete perqind te kapitalit te shoqerise, me perjashtim te rastit kur blerja, shitja apo hipotekimi i ketyre pasurive eshte pjese e planit vjetor te zhvillimit te shoqerise.
- marrja e letrave me vlere ose garancive te tjera te shoqerive te pa-afiliuara (te palidhura mbi baze juridike dhe pronesie) per transaksione qe nuk hyjne ne biznesin kryesor te shoqerise.
- marrja e borxheve, dhenia e borxheve kompanive te pa-afiliuara (te palidhura mbi baze juridike dhe pronesie) per transaksione qe nuk hyjne ne biznesin kryesor te shoqerise.
- pranimi i pegjegjesive te pakufizuara per llogari te shoqerise.

Kufizimet e autoritetit vendim-marres te administratorit mundet po ashtu te percaktohen nga rregullat dhe procedurat e drejtimit te shoqerise.

11.8 Ne varesi te vendimit te Ortakut te Vetem, administratoret e shoqerise mund te kene te drejte e pjesmarrjes ne fitim, zakonisht vetem nese fitimi e tejkalon mesataren e pritshme prej 10(dhjete) perqind te fitimit vjetor; administratori ka te drejte vetem mbi pjesen shtese te fitimit. Nese drejtimi i shoqerise perbehet nga me shume se nje administrator pjesa totale e fitimit e te gjithë administratoreve nuk mund te kaloje 10% (dhjete perqind) te shumes qe kalon fitimin mesatar te parashikuar te vitit te fundit kontabel; pjesa e fitimit individual nuk mund te kaloje 3,5% (tre pike pese perqind) te shumes qe mbi masen e fitimit mesatar te parashikuar per vitin e fundit kontabel. Pjesa e fitimit e administratoreve dhe sasite korresponduese do te percaktohen nga Ortaku i Vetem.

12. Perfaqesimi i shoqerise, perfaqesimi me shkrim

12.1. Shoqeria perfaqesohet nga administratori/administratoret e saj te pergjithshem-si perfaqesues i saj ligjor tek palet e trea, si dhe perpara gjykates apo autoriteteve te tjera. E drejta statutore e perfaqesimit e administratoreve mund te kufizohet me ndryshimet e mevonshme ne Statutin e shoqerise, ose mund te shperndahet mes disa drejtuesve te tjere ekzekutive. Çdo kufizim apo ndarje e se drejtes se perfaqesimit do te konsiderohet null dhe i pavlefshem perkundrejt paleve te treta.

12.2. Administratori mund autorizojë persona te tjere per te lidhur marreveshje apo transaksione te caktuara ligjore (autorizim i pergjithshem) ose te lidhe marreveshje specifike individuale dhe transaksione te tjera ligjore individuale te percaktuara (autorizim i vecante) nepermjet leshimit te nje dokument perkates me shkrim. Persona te tille te autorizuar mund te leshojne nje dokument me shkrim duke autorizuar nje person te trete te perfaqesojë shoqerine brenda kufijve te autoritetit te tyre vetem me pelqimin me shkrim te Administratorit.

12.3. Administratori ka te drejte te nenshkruaje ne menyre te pavarur çdo dokument ne emer te shoqerise. Metoda e nenshkrimit duhet te ndodhe ne nje menyre qe personi i autorizuar te nenshkruaje duhet te shkruaje emrin e saj/tij te vertetuar nga Noteri mbi emrin e shoqerise te shkruar me dore, te printuar apo te vulosur. Ne rast se drejtimi shoqerise do perbehet nga me shume se nje administrator atehere administratoret do te perfaqesojne shoqerine bashkarisht, pervec rasteve kur parashikohet ndryshe me vendim te mevonshem te themeluesit.

13. Mbarimi i shoqerise

13.1. Shoqeria mbaron kur :

- Ortaku i Vetem/Themeluesi e shperndan shoqerine,
- shoqeria bashkohet me nje sipermarrje tjeter biznesi, ndahet te dy ose me shume sipermarrje, ose konvertohet ne nje tip tjeter shoqerie,
- Qendra Kombetare e Biznesit e c' regjistron shoqerine sipas parashikimeve te Ligjit nr. 9901 date 14/04/2008.

13.2. Ne rastin e mbylljes se shoqerise pa suksesor (pa u trashëguar), pasurite qe ngelen pas shlyerjes se te gjitha borxheve do t'i kalojne Ortakut te Vetem/Themeluesit.

14. Dispozita ndihmese dhe perfundimtare

14.1. Çeshtjet qe nuk rregullohet nga ky Statut do te rregullohen nga Ligji Nr. 9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndersa Kodi Civil do te aplikohet ne lidhje me marredheniet financiare dhe personale te shoqerise dhe ortakut/ortakeve te saj te parregulluara nga Ligji i Shoqerive Tregtare.

14.2. Kostot qe lidhen me formimin e shoqerise parapaguhet nga nga Ortaku i Vetem , por do ti mbarten vete shoqerise.

14.3 Ne rastin ndonje dispozite e Statutit behet e pavlefshme ose eshte shfuqizuar per cfaredo lloj aresyeje, Ortaku i Vetem duhet ta zevendesoje dispoziten e pavlefshme me nje te re, i cila lejohet nga Ligji dhe, nese eshte e mundur, arrin te njejtin qellim ekonomik si dhe ajo e meparshmja qe u zevendesua.

14.4. Mosmarreveshjet ligjore mes Ortakut te Vetem dhe shoqerise , te cilat nuk mund te zgjidhen me negociata miqesore mes paleve, do te jene objekt gjykimi nga Gjykata e Tiranes.

14.5. Ortaku i Vetem dhene te drejten Z. Naim Isufi, Avokat, mbajtes i lejes me Nr. 651 date 29.12.1997 prane Dhomes se Avokateve Tirane te redaktoje statutin, dhe te veproje si perfaqesues per sherbimet e procesit te regjistrimit ne emer Ortakut te Vetem. Prokura/Autorizimi si dhe emrimi per te vepruar si perfaqesues ne procesin e regjistrimit leshohen me ane te nje dokumenti te vecante.


14.6 Ne rast dyshimesh apo mosmarreveshje te lidhura me interpretimin e permbajtjes se ketij dokumenti, versioni Shqip do te kete perparesi.

Krško-Tirana, me 19 Dhjetor 2017

Themeluesi:

GEN-I, trgovanje in prodaja električne energije, d.o.o.

Robert GOLOB Ph.D.
Kryetari i Bordit Drejtues



Andrej ŠAJN M.Sc.
Anetar i Bordit Drejtues



gen-i

02

GEN-I, trgovanje in prodaja
električne energije, d.o.o.
Vrbina 17, SI-8270 Krško, Slovenija

